



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 109/2013
Prishtinë, më 5.06.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N–303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha – Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Fikrim Damka, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrës i ftuar: Ekrem Hoxha, kryetar i Bordit i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Pjesëmarrës të tjerë: Besnik Berisha, Ilir Imeri, Visar Halimi dhe Nazmi Rrahimi - ARKEP; Ukë Gashi – ZPRK; Qëndresa Mrasori, praktikante.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012

Kryetari, theksoi se ashtu siç është paraparë, në këtë pikë të rendit të ditës, do të shqyrtohet Raporti vjetor i Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012. Ne kemi ftuar përfaqësuesin e ARKEP-së, z. Ekrem Hoxha, i cili do të paraqesë një ekspozë të shkurtër për këtë Raport dhe pastaj do të hapet debati.

Ekrem Hoxha, kryetar i Bordit të ARKEP-së, paraqiti një ekspozë të raportit, duke theksuar se raporti është hartuar brenda afatit ligjor dhe në përputhje me kërkesat që parasheh Ligji për Komunikime elektronike dhe postare. Ai tha se gjatë vitit 2012, janë zhvilluar aktivitete të shumta për vitin 2012 dhe raporti është një përmbledhje objektivave ekzekutive. Hoxha theksoi se në raport janë paraqitur aktivitetet në mënyrë kronologjike. Ai pastaj e ofroi një pasqyrë të punës së deritashme, sfidat dhe të arriturat e ARKEP-së. Fillimisht, drejtori Hoxha tha: "Aktivitetet e ARKEP-it, gjatë vitit 2012, kanë qenë të përqendruara në arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjike, të përcaktuara për rregullimin e shërbimeve telekomunikuese dhe shërbimeve postare, me theks të veçantë në ruajtjen dhe promovimin e konkurrencës efektive dhe të qëndrueshme". Duke paraqitur të arriturat e ARKEP-së, kryetari i saj veçoi arritjen e gjendjes optimale në harmonizimin e ndarjes së brezave frekuencorë për operatorët ekzistues, vendimin e Qeverisë së Kosovës, sipas rekomandimit të ARKEP-it, për liberalizimin e mëtutjeshëm të shërbimeve telekomunikuese mobile, miratimin e shenjës thirrëse (prefiksit) dhe funksionalizimi i shërbimeve radio amatore. Ai në vijim, tha se ARKEP-i e ka përmbyllur me sukses planin afatmesëm, për harmonizimin e legjislacionit të aplikueshëm me kërkesat. Ai, po ashtu njoftoi edhe për telefoninë fikse dhe atë mobile, ndarjen e tregut sipas përdoruesve, mbulueshmërinë dhe elementet e rrjetit, për tarifat e thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Hoxha, tha që kemi arritur dy marrëveshje për kodin e brezit ndërkufitar me Malin e Zi dhe Shqipërinë, po ashtu gjatë viti 2012, kemi pas dy zgjedhje të arbitrazhit në mënyrë pozitive për ARKEP-in. Duke folur për buxhetin, ai tha, që dy vitet e fundit nga raporti i Auditorit të Përgjithshëm, nuk kemi asnjë vërejtje, për mënyrën e menaxhimit të buxhetit.

Teuta Sahatqija, tha që prej vitit të kaluar po shihet që ka ndryshime pozitive në realizimin e shumë objektivave, por ka ende sfida për t' u realizuar, por edhe disa objektiva të tjera që e presin ARKEP-in. Ajo me këtë rast, parashtrroi disa pyetje, për Z6, cili prej institucioneve e ka dhënë licencën dhe si po menaxhohet? Kërkoj sqarime për 3G dhe 4G dhe pyeti se a ka operatorë të interesuar? Për ata që e kanë marrë brezin e frekuencave, pse nuk ka më shumë detaje ne raport? Lidhur për harmonizimin e frekuencave, a keni në plan edhe harmonizimin më ndonjë shtet tjetër, pos Malit të Zi dhe Shqipërisë? Për sinjalin digjital a keni informata për mbulimin më frekuenca?

Myzejene Selmani, tha që raporti prej vitit të kaluar është i hartuar më mirë, ku ceken me më shumë detaje të arriturat. Ajo pyeti se sa po zbatohet strategjia digjitale dhe licencat? Për kodet e telefonisë fikse dhe mobile a jeni të ftuar në bisedimet që po zhvillohen në Bruksel në mes Kosovës dhe Serbisë? Selmani kërkoi sqarime shtesë për një operator të ri nga Serbia.

Lutfi Zharku, pyeti se kur do ta kemi edhe një operator të ri të telefonisë mobile?

Hashim Deshishku, pyeti se a po funksionon operatori i telefonisë mobile 043? A është duke marrë pjesë ARKEP-ja në bisedime që po zhvillohen për telekomunikacionin me ekspertë?

Shaip Muja, pyeti për formën e komunikimit më internet, se sa kjo ka reflektuar në të hyra? Për operatorët virtual, a pritet më pas edhe ndonjë operatorë prej Serbisë? Për operimet e TT si TANGO; VIBER; SKYPE, a përfiton shteti nga këta operatorë? Për teknologjinë e antenave nga operatorët, a ka analiza se a kanë implikime shëndetësore, dhe vendosja e tyre a është e rregulluar në bazë të kriterëve nga ARKEP-ja, apo i vendosin vet sipas interesave të tyre ?

Sala Berisha –Shala, tha se në bazë të raportit të punës së ARKEP-it, për vitin 2012, po shihet së në krahasim më shtetet e rajonit, i kemi tarifat më të ulëta për operatorët që u cekën të telefonisë dhe pyeti se sa a kemi të bëjmë me tregun e vogël të konsumatorëve, apo me konkurrencën dhe pse po ndodhë kjo? Ajo shtroi edhe pyetjen, se cili është shfrytëzimi i këtyre operatorëve, si fjala vjen SKYPE, a po përdoren shumë?

Ekrem Hoxha, kryetar i Bordit të ARKEP-së, Ju përgjigj pyetjeve që ngritën anëtarët e Komisionit. Për çështjen e kodit shtetëror të telefonisë, tha se prej marsit të viti 2011, kemi marrë pjesë aktive në dialog, që është zhvilluar në Bruksel në mese palës së Kosovës dhe të Serbisë. Ai tha se Kosova kodin shtetëror të telefonisë dhe internetit duhet ta merr nga ITU-ja dhe miratimin nga OKB-ja. Për Z-6, Hoxha tha se Qeveria ka marrë vendim, por duhet edhe radio amatorët të kenë licencë nga ITU-ja Për marrëveshjet ndërkufitare, për brezin frekuencor, tha që jemi në bisedimet edhe më Maqedoninë, dhe shumë shpejt pritet nënshkrimi i marrëveshjes. Për agjendën digjitale, tha që ky sektor është i rregulluar më Ligj, por na duhet mbështetje me mjete financiare, për ta realizuar këtë sektor. Për 3G dhe 4G, tha që më maj të vitit 2013, si bord kemi marrë vendim që operatoreve t'ju mundësohet lejimi i shërbimeve, por operatorët që shfrytëzojnë këtë rrjet duhet t'i bëjnë pagesat administrative, ndërsa Ministra e Financave, duhet të merret me çmimin se sa do të jetë kostoja financiare, theksoi se varet prej operatorëve se çfarë teknologjie do të përdorin. Se a do të ketë operatorë të ri të telefonisë mobile, Hoxha tha që kjo çështje rregullohet në bazë të ligjit dhe ne si ARKEP, vetëm mund të përgatisim sektorin e legjislacionit sekondar, ndërsa Qeveria është ajo që duhet të merr vendim. Kjo varet se sa do të ketë rritje të përdoruesve, dhe do të pritet deri në rritjen e konkurrencës. Për ndikimin platformave që përdorin internetin, tha që kemi pas rritje më të madhe të përdoruesve të internetit, dhe kemi ulje të thirrjeve të telefonisë mobile. Se a do të ketë operatorë të telefonisë nga Serbia, ai tha që në agjendën tonë të ARKEP-së, nuk do të ketë, por licencat me ligj duhet t'ju japim të gjithë operatorëve që i plotësojnë kushtet. Më herët, ne kemi pas strategjinë 2007-2012, të kemi vetëm dy operatorë, ndërsa tani strategjia e re, 2013-2020, nuk e di se a do të lejojë futjen e edhe të një operatori, por tha se kjo çështje do jetë e hapur. Në fund, Hoxha tha se tregu i telefonisë mobile në Kosovë, është mjaft kompetitiv dhe me standarde të BE-së.

Besnik Berisha, anëtari Bordit të ARKEP-së, iu përgjigj pyetjes lidhur, për operatorët digjitalë, duke thënë se problemi qëndron prej vitit 2006, kur është mbajtur nga ITU-a një konferencë në Gjenevë, dhe aty është përjashtuar Kosova nga rrjeti digjital dhe është thënë se mund ta shfrytëzojnë operatorët e Serbisë. Mirëpo, shtoi Berisha, mund t'i shmangemi kësaj marrëveshje, pasi që tash Kosova është shtet dhe nuk kemi obligime ndaj kësaj marrëveshje. Tani kemi filluar me draftimin e Projektligjit për digjitalizim dhe kjo çështje prite të rregullohet shumë shpejt.

Ilir Imeri, ARKEP, duke folur për çështjen të hyrave që po zvogëlohen nga telefonia mobile, tha që kjo po ndodhë si rezultat i teknologjisë shumë të përparuar të internetit, për zbritjen e tarifave për operatorët, kjo ulje ka ardhur me nivelin e ulët të përdoruesve dhe shfrytëzimit, por kjo varet edhe prej konkurrencës në treg. Për operatorin 043, tha që ekziston, por ka shumë pak konsumatorë. Tarifat janë shumë komplekse dhe varet se operatori çfarë shporte ofron për klientin.

Visar Halimi, ARKEP, shtoi se lidhur me Z6, se është një shenjë e thirrjeve që merret nga ITU-ja. Kjo shenjë është e rezervuar për Kosovën, tani vetëm pritet licencimi nga ITU-ja. Për antenat e vendosura nga operatorët, kjo bëhet në shumicën rasteve në bashkëpunim me komunat, por edhe kjo çështje duhet të rregullohet me ligj, për shkak të rrezikut shëndetësor që mund të shkaktojnë antenat. Sipas matjeve dhe analizave që janë bërë, nuk ka rezultuar që mund të kenë rrezikshmëri për shëndetin dhe më shumë kemi rrezik nga telefoni mobil në xhep dhe Wireless-i.

Nazmi Rrahimi, ARKEP-ja, duke folur për shërbimet postare, tha janë të suksesshme dhe ARKEP-ja i ka licencuar 8 shërbime postare, kryesisht këto shërbime kryhen nga sektori publik, Posta e Kosovës.

Teuta Sahatqija, pyeti për platformën radio-komunikuese se si po funksionon dhe për fibrat optikë a ekzistojnë dhe ka do një operatorë që i shfrytëzon?

Ilir Imeri, ARKEP, tha që këto çështje që u ngritën, trajtohen me Ligjin për Komunikimet Elektronike dhe Postare. Po ashtu, edhe bashkëshfrytëzimi i fibrave optikë, rregullohet me rregullore të aprovuara nga ARKEP-ja, por është vendim dhe çështje e operatorëve a do të shfrytëzojnë këtë fibër optik.

Kryetari i Komisionit, **Zenun Pajaziti**, në fund të diskutimeve që u bënë dhe përgjigjeve që morën deputetët lidhur me interesimin e tyre, për raportin e ARKEP-së, për vitin 2012, i vlerësoi pozitivisht edhe si raportin më profesional. Ai, po ashtu, në emër të Komisionit e inkurajoi kryesuesin, z. Hoxha dhe stafin e ARKEP-së, që të vazhdojnë me këmbëngulësi për t'ju përmbajtur obligimeve ligjore. Pajaziti theksoi se për t'i tejkaluar sfidat që mund të paraqiten gjatë zbatimit të Ligjit për komunikimet elektronike dhe postare, do t'ju ofrojmë mbështetjen e vazhdueshme të Komisionit.

Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për vitin 2012.

Komisioni ia paraqet Kuvendit këtë

R e k o m a n d i m

- 1. Të miratohet Raporti vjetor i punës për vitin 2012, i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për vitin 2012.*
- 2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet kryetari i Komisionit, Zenun Pajaziti.*

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-181, për produktet e ndërtimit

Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit, tha se edhe pse i ka tejkaluar të gjitha afatet për shqyrtim, Komisioni për Komunitete, ka kërkuar sqarime dhe informacione shtesë, lidhur me amendamentet 11;17;20;22;23;33 dhe 34, në Projektligjin Nr. 04/L-181, për produktet e ndërtimit sepse sipas tyre cenojnë rëndë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Hashim Deshiku, tha hartimi i këtyre amendamenteve nuk pas ndonjë qëllim për ta penguar përdorimin e gjuhëve zyrtare, por vetëm për ta bërë Projektligjin sa ma të qartë dhe për ta mos e

ngarkuar me tekstin e tepruar, sepse kjo çështje rregullohet me Kushtetutë. Ai theksoi se është respektuar çdo herë dhe po respektohet përdorimi i gjuhëve zyrtare.

Lutfi Zharku, propozoi që në ato nene, ku është fshi fjala “gjuhët zyrtare”, të fshihen ato amendamente 11;17;20;22;23;33 dhe 34, në Projektligjin Nr. 04/L-181, për produktet e ndërtimit, ndërsa amendamentet 20 dhe 22, të rregullohen dhe spastrohen sepse nuk është fshi vetëm fjala gjuha zyrtare.

Komisioni vendosi që amendamentet 11;17;20;22;23;33 dhe 34, në Projektligjin Nr .04/L-181, për produktet e ndërtimit të fshihen dhe për këto ndryshime të informoj Komisionin e përhershëm për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

Pas debatit, me pesë (5 vota) për, dhe 1 (një) kundër, Komisioni nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit Nr .04/L-181, për produktet e ndërtimit .*
- 2. Raporti t'i procedohet Kuvendit, sipas procedurës për lexim të dytë.*

4. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Kryetari, i njoftoi deputetët se për shqyrtimin Projektligjit për Tregun dhe Produktet e Naftës, që është pike rendit të ditës për seancë plenare, ka marrë një kërkesë nga znj. Mimoza Kusari-Lila, ministre e Tregtisë dhe Industrisë, që të hiqet nga rendit i ditës, nga seanca e datës 6.6.2013.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetar i Komisionit,
Zenun Pajaziti**